



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 23 (827878)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 14 qershor 2024

Ministri Peleshi: Shqipëria së shpejti do të ketë vendin e saj në industrinë ushtarake të Aleancës



» faqe 2-3

SHSHHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji priti shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së të Turqisë, gjeneral Metin Gürak

Me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve të Turqisë, gjeneral Metin Gürak.

Gjeneral Kingji, pasi i uroi mirëseardhjen gjeneralit Gürak dhe ekipit që e shoqëronte, shprehu mirënjohjen për mbështetjen e kontributin që Forcat e Armatosura të Turqisë kanë dhënë ndër vite, duke luajtur një rol të rëndësishëm në reformimin, transformimin, dhe modernizimin e Forcave tona të Armatosura.

Në mënyrë konkrete, gjeneralmajor Kingji theksoi mbështetjen me ekspertë nga Forcat e Armatosura të Turqisë për forcat tona komando, në bazën detare Pashaliman, mundësinë për t'u arsimuar në institucionet arsimore të Turqisë, mbështetjen logjistike dhe zhvillimin e kapaciteteve, trajtimin shëndetësor në Turqi, dhe angazhimin e përbashkët në operacione dhe stërvitje të ndryshme.

Po kështu, gjeneralmajor Kingji vlerësoi ndihmën e ofruar nga qeveria turke në menaxhimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 dhe përballimin e pasojave të pandemisë COVID-19.

Më tej, bashkëbisedimi u fokusua në zhvillimet e fundit në Forcat e Armatosura, përmirësimet strukturore dhe ligjore, rishikimin e dokumenteve strategjike, ecurinë e projekteve të modernizimit, zhvillimin e infrastrukturës ushtarake, kontributin në misionet dhe operacione, masat e marra në kuadër të shkurajimit dhe mbrojtjes dhe planeve rajonale, etj.

Gjeneralmajor Kingji u ndal dhe në zhvillimet e fundit në mjedisin e sigurisë në zonën Euro – Atlantike dhe sidomos në Ballkanin Perëndimor, ku influenca malinje dhe retorika konflikt ndjellëse



e disa aktorëve synon tensionimin e situatës dhe pengimin e zhvillimit normal të proceseve integruese.

Në këtë pikë, gjeneralmajor Kingji vlerësoi rolin e pazëvendësueshëm të Turqisë për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit, rolin e KFOR-it për sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë dhe kontributin domethënës të Turqisë në këtë operacion.

Po kështu, gjeneralmajor Kingji vlerësoi rolin e iniciativave rajonale për promovimin e bashkëpunimit dhe stabilitetit në rajon, ku dhe e falënderoi gjeneral Gürak për pjesëmarrjen dhe vlerën e shtuar që ai solli në konferencën e 17 të shefave të Shtabit të Ballkanit, të mbajtur në Durrës më datën 06 qershor 2024.

Në fjalën e tij, gjeneral Gürak vlerësoi bashkëpunimin tonë dypalësh dhe angazhimin e tij për ta avancuar atë dhe më tej në të ardhmen, në të gjitha fushat, ku FARSH ka interes.

Ai theksoi rolin konstruktiv të vendit tonë për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit dhe qëndrimin e palës turke se një Shqipëri e fortë është një kontributi më i mirë për një rajon të sigurt.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve të Turqisë, gjatë vizitës zyrtare në vendin tonë ka zhvilluar takime zyrtare me Presidentin e Republikës së RSH, SH.T. z. Bajram Begaj dhe me ministrin e Mbrojtjes, z. Niko Peleshi.



Përfundoi me sukses Kursi Bazik Teknik/ Mekanik Helikopteri

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore, Kuçovë, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazik Teknik/Mekanik Helikopteri. Në këtë ceremoni mori pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Luan Sadiku, i cili theksoi rëndësinë e këtij kursi që shërben për të përgatitur personelin për të punuar në teknikën ajrore, si dhe shtoi rëndësinë e kurseve në zhvillimin e mëtejshëm profesional. Përgjatë këtyre 14 javëve janë trajnuar 6 kursantë me kurrikulat mësimore më të avancuara. Arsimimi, kualifikimi dhe trajnimi i personelit është element thelbësor që shërben si bazë solide për krijimin e një trupe profesionale për t'u përgjigjur kërkesave dhe sfidave në rritje në një mjedis sfidues sigurie.

Pas dhënies së certifikatave, ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët.



Në Distriktin Detar Jugor u zhvillua konferenca përfundimtare planëzuese për stërvitjen "GrupEx-24" dhe për stërvitjen "Imponimi-24"

Në mjediset e Komandës së Distriktit Detar Jugor, Pashaliman, u zhvillua Konferenca Përfundimtare Planëzuese (FPC) për Stërvitjen "GrupEx-24" dhe për stërvitjen "Imponimi-24" si pjesë e Stërvitjes Kombëtare 3-shkallëshe "Përpjekja e Përbashkët - 24", si dhe qitjet bregdetare të planifikuara për t'u zhvilluar më datë 24-28 qershor 2024.

Fokusi i kësaj stërvitjeje është përmirësimi i koordinimit midis institucioneve me interesa në det në përgjigje të një situatë operacionale detare si dhe testimi i kapaciteteve reaguese të Forcës Detare/Rojës Bregdetare, strukturave të vartësisë së saj Distriktit Detar Jugor, Distriktit Detar Verior si dhe strukturave ligjzbatuese me interesa në det. Stërvitja ka gjithashtu për qëllim aftësimin e shtabeve pjesëmarrëse në planëzimin e stërvitjeve të këtij niveli dhe zhvillimin e operacioneve MIO. Konferenca u organizua në dy pjesë: Stërvitja "Imponimi-24" e planëzuar për t'u zhvilluar me pjesëmarrje të Distriktit Detar Jugor, Distriktit Detar Verior, Forcës Tokësore (Regjimenti Operacioneve Speciale), Forcës Ajrore, Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe Policisë Kufitare de Migracionit. Stërvitja "GrupEx-2024" dhe qitjet bregdetare me temë: "Vlerësim dhe certifikim i grupeve të anijeve si njësi zbatuese, testimi i aftësive organizative dhe komanduese të komandave dhe shtabeve të distrikteve detare si dhe kryerja e qitjeve bregdetare me armatimin e anijeve.

KKSHP, vizitë në Komandën Mbështetëse

Kursantët e Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm vizitojnë Komandën Mbështetëse.

Departamenti i Udhëheqjes Ushtarake (DUU) pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë inicioi dhe koordinoi me Komandën Mbështetëse, vizitë njohëse për kursantët e Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP).

Gjatë vizitës mësimore, në mbështetje të programit akademik, kursantët u njohën me anë të prezantimeve me historikun, misionin, strukturën, detyrat aktuale si dhe pjesëmarrjen në misionet të personelit xhenier dhe jo vetëm në kuadër të NATO-s dhe më gjerë. Kursantët drejtuan pyetje mbi sfidat, praktikat e punës në shtab si dhe angazhimet e kësaj komande si një ndër njësitë kryesore të Forcave tona të Armatosura.



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në një takim mes përfaqësuesve të Agjencisë së NATO-s për Komunikimin dhe Informacionin (NCIA - NATO Communications and Information Agency), të Mbështetjes dhe Prokurimit (NSPA - NATO Support and Procurement Agency) si dhe të Departamentit Amerikan të Mbrojtjes me përfaqësues të dhomave të tregtisë, industrisë, sipërmarrës, kompani e biznese.

Ky aktivitet i titulluar “Dita e Industrisë” kishte si synim dhënien e një informacioni mbi procedurat e prokurimit, legjislacionit dhe kushtet që duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë në Shqipëri për të marrë pjesë në prokurimet ndërkombëtare, por edhe për të përcaktuar një bashkëpunim mes bizneseve shqiptare dhe agjencive të NATO-s.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi nxiti përfaqësuesit e biznesit të aplikojnë dhe të përfitojnë nga këto projekte, duke shprehur nga ana tjetër gatishmërinë e Ministrisë së Mbrojtjes për krijimin e urave të duhura të bashkëpunimit ndërmjet operatorëve privatë shqiptarë dhe përfaqësuesve të strukturave me përvojë të NATO-s.

“Konfliktet kanë bërë që kërkesa të rritet shumë për armatime, për ushqime apo mallra të tjera që prokurohen në këto agjenci të NATO-s. Bota e madhe e konflikteve në rritje, ka sjellë edhe rritje të kërkesës dhe ne ju ftojmë të përfitoni nga këto kontrata. Tashmë keni më shumë se 30 vite eksperiencë. Kemi kompani të shkëlqyera që sa herë kanë dalë jashtë vendit kanë fituar besim për shkak se e kanë rritur standardin”, - u shpreh Ministri i Mbrojtjes.

Në këtë aktivitet që u mbajt në Qendrën e Inovacionit, ministri Peleshi evidentoi edhe disa nga projektet që po marrin jetë në këtë



Ministri Peleshi: Shqipëria së shpejti do të ketë vendin e saj në industrinë ushtarake të Aleancës



kundërta është e vërtetë. Ne kemi sot mundësi të mëdha, edhe kombëtare, por mbrapa nesh është një perde tjetër, e cila do të hapet sot dhe është shumë herë më e madhe, mundësia e NATO-s”, - shpjegoi ministri Peleshi.

Para sipërmarrësve, ministri foli edhe për nismën e re për rigjallërimin e industrisë ushtarake në vend: “Ne po punojmë fort për të ndërtuar kuadrin ligjor dhe më vonë edhe institucional të industrisë ushtarake në vendin tonë. Të gjithë e dini që ne vijmë nga një e kaluar e një gjigandomanie të ushtrisë, ku i gjithë populli ishte ushtar, pastaj u pasua nga një kohë tjetër e detyrueshme, demilitarizimi dhe, sot, jemi në një kohë kur e kemi tejkaluar këtë pjesë të historisë. Jemi anëtarë të NATO-s, duam dhe duhet të luajmë edhe ne pjesën tonë në industrinë

ushtarake të Aleancës. Kemi asete të së shkuarës, të cilat me investime të përbashkëta mund të riaktivizohen. Por së pari na duhet një kuadër ligjor i përshtatshëm dhe incentiva për investime. Kemi parasysh këtu jo vetëm investitorë të huaj, por kemi edhe investitorë shqiptarë, që mund të mos kenë përvojë në këtë fushë, por janë të gatshëm të jenë partnerë në këtë industri të re që do të fillojë të marrë jetë që këtë vit. Është një takim për të hapur perdet e mundësive dhe për të bashkëpunuar me sipërmarrjet shqiptare”, - u shpreh z. Peleshi.

“Dita e Industrisë” lindi si një ide në Bruksel në muajin shkurt. Ndaj në këtë takim ministri i Mbrojtjes falënderoi edhe Dorina Canin, oficere për kontratat pranë Agjencisë së NATO-s, për Komunikimin dhe Informacionit (NCIA), e cila kontribuoi në organizimin dhe dhënien e informacionit të nevojshëm për përfaqësuesit e biznesit.



qendër e që do t'u vijnë në ndihmë sipërmarrjeve.

“Deri dje ka patur një mur mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe botës së biznesit. Dukej një tabu dhe një sektor i padepërtueshëm për ç’ ka ndodh sot në botën e inovacionit dhe teknologjisë. E

Atashtetë Ushtarakë të akredituar në vendin tonë, zhvilluan vizitë njohëse në Komandën Mbështetëse

Në kuadër të planit të aktiviteteve të atashëve të akredituar në vendin tonë, në ambientet e Komandës Mbështetëse u zhvillua një vizitë njohëse e trupës së Atasheve Ushtarakë, rezident dhe jo rezident, me qëllim rritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe ndërveprimit në fushën e mbrojtjes.

Atasheu ushtarak i Çekisë, kolonel Radim Jonas, atasheu ushtarak i Gjermanisë, kolonel Hans Peter Wamsler, atasheu ushtarak i Turqisë, kolonel Tolga Kip, atasheu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar, kolonel Timothy Wight Boycott, atasheu ushtarak i Kosovës, kolonel Enver Hoti, atasheu ushtarak i Bullgarisë, kolonel Miroslav Sandrev, atasheu ushtarak i Polonisë, kolonel Przemyslaw Balut, atasheu ushtarak i Italisë, kolonel Agostino Piccirillo, atasheu ushtarak i Greqisë, kolonel Ioannis Mokos, dhe atasheu ushtarak i Kroacisë, kolonel Stjepan Domjancic, u mirëpritën nga zëvendës komandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, i cili iu uroi mirëseardhjen dhe shprehu mirënjohjen për mbështetjen e kahershme që vendet e tyre kanë ofruar për Forcat e Armatosura dhe Komandën Mbështetëse në veçanti. Përmes një prezantimi, përfaqësuesit ushtarakë u njohën me misionin e Komandës Mbështetëse, me transformimet strukturore që ka pësuar ndër vite, detyrat kryesore, kapacitetet aktuale, objektivat, prioritetet dhe fokusin për të ardhmen.

Atashtetë Ushtarakë shprehën interes në



lidhje me modernizimin e sistemeve, pajisjeve dhe teknikës që Komanda Mbështetëse përdor në përmbushjen e objektivave operacionale, si dhe implementimin e ligjit të ri në lidhje me kompletimin e strukturave rezerviste.

Aktiviteti përfundoi me shkëmbimin e dhuratave simbolike midis përfaqësuesit të trupës së Atasheve Ushtarake, kolonel Radim Jonas dhe zëvendës komandantit të Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela.



Përfundoi operacioni EOD, në njësinë administrative nr.11, bashkia Tiranë

Nga punimet e kryera në rrugën “Benjamin Kruta”, njësinë administrative nr. 11, bashkia Tiranë, është identifikuar një municion i rrezikshëm.

Ekipi i ekspertëve të kompanisë EOD, në përgjigje të njoftimit të marrë nga strukturat përgjegjëse, është dislokuar pranë territorit, ka bërë rrethimin e perimetrit të zonës, ku është gjetur municioni dhe me profesionalizëm e përgjegjësi të lartë ka konstatuar se municioni i identifikuar ishte një bombë amerikane me nomenklaturë AN-M64 240 kg me djegore majore të montuar.

Duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik të parashikuar në manualin EOD, efektivet e kompanisë EOD, bënë heqjen e djegores dhe më pas transportimin dhe magazinimin e municionit në ambientet e Batalionit të Xhenios.



Ekspertët xhenierë përfundojnë një tjetër operacion në bashkinë Fiq

Ekspertët xhenierë të kompanisë EOD, janë angazhuar në mbështetje të emergjencave civile të bashkisë Fiq, qarku Vlorë.

Banorë të fshatit Dërmish, në njësinë Administrative Dhivër, bashkia Fiq kanë identifikuar disa municione të tipit granata dore. Ekspertët xhenierë, pjesë e operacionit për vlerësimin dhe largimin e municionit të gjetur, pas këqyrjes me vëmendje kanë konkluduar se municioni, granata dore, është i lëvizshëm.

Duke zbatuar me rigorozitet masat e sigurisë, specialistët EOD, kanë bërë transportimin dhe magazinimin e municionit në ambientet e Batalionit të Xhenios.

ZVSHSHPFPA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu zhvilloi vizitë zyrtare në Pentagon të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Në kuadrin e bashkëpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, së bashku me kolonel Arben Toska me detyrë zëvendëskomandant i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kreu një vizitë zyrtare në Pentagon në Uashington DC të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Gjatë vizitës gjenerale Shehu u shoqërua nga atasheu ushtarak i Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kolonel Flori Suli.

Gjenerale Shehu dhe delegacioni që e shoqëronte u prit në takime të veçanta nga: gjeneralmajor Jami C. Shawley, drejtore e J5 për Iniciativat Strategjike; znj. Sandy Long, këshilltare e Lartë në fushën e Eksporteve të Armatimeve dhe Pajisjeve Ushtarake; gjenerallejtënant Laura Potter, drejtore e Shtabit të Forcave të Armatosura në Pentagon.

Në këto takime u bisedua rreth zhvillimeve aktuale të sigurisë globale dhe në rajon; Zhvillimi dhe modernizimi i kapaciteteve të Forcave të Armatosura; kontributi i Shqipërisë në NATO



dhe operacionet e drejtuara nga SHBA; Disponueshmëria e infrastrukturës kombëtare në dispozicion të NATO-s dhe SHBA; Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara "Gruaja, Paqja dhe Siguria", etj.

Në fjalën e saj gjenerale Shehu, pasi i falënderoi për ftesën për të qenë në krye të delegacionit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së me shqiptare në këtë vizitë të rëndësishme, përmendi bashkëpunimin e shkëlqyer të Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku theksin e vuri në bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe konkretisht në fushat kryesore si të: edukimit, trajnimit dhe stërvitjes, arsimimit ushtarak, transformimit dhe modernizimit të FARSH-së, asistencës teknike për përgatitjen e dokumenteve kryesore strategjike, krijimit dhe mbështetjes së iniciativave rajonale, binjakëzimit me New Jersey National Guard, programit të asistencës humanitare, bashkëpunimit për sigurinë, binjakëzimit të AFA-së me Akademine e "West Point", etj.



Në takimin me gjeneralmajor Jami C. Shawley, me detyrë drejtore e J5 për Iniciativat Strategjike

Gjatë takimit u fol për situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor, situatën aktuale në Ukrainë dhe mbi konfliktin në Lindjen e Mesme. Implikimet e ndërhyrjes së Rusisë, Iranit në vendin tonë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Gjenerale Shehu falënderoi mbështetjen që SHBA-ja ka dhënë në përballimin e sulmeve kibernetike intensive Iraniane ndaj sistemeve dhe portaleve Qeveritare, si dhe vlerësoi rëndësinë e pranisë së SHBA-ve në Shqipëri dhe Rajonin e Ballkanit Perëndimor.



Në takim u theksua dhe u vlerësua roli i FARSH-ve në misionet e ndryshme të drejtuara nga SHBA-të, NATO, BE dhe UN, ndihma e dhënë nga FARSH për Ukrainën, Prezenca e KFOR-it dhe e SHBA-ve në rajon dhe më gjerë.

Në takimin me znj. Sandy Long, Këshilltare e Lartë në fushën e eksporteve të Armatimeve dhe pajisjeve Ushtarake

Një takim të veçantë gjenerale Shehu pati me Zonjën Sandy LONG, e cila është Drejtuesja e Zyrës së Eksporteve të armatimit

dhe pajisjeve ushtarake të SHBA-ve si dhe është Këshilltare e Lartë për Zyrën e Eksportit të Mbrojtjes të Zëvendës Ndihmës Sekretarit të Mbrojtjes për Eksportet e Mbrojtjes dhe Bashkëpunimin.

Gjatë takimit u diskutua mbi zhvillimin e programeve të mbrojtjes dhe projekteve të modernizimit për rritjen kapaciteteve të FARSH, në kuadër të angazhimeve të FA-së në operacionet e NATO-s dhe me ato të drejtuara nga SHBA. Mbi prioritetet dhe përparësitë për realizimin e Objektivave të Kapaciteteve që FARSH ka në kuadër të angazhimeve me NATO-n si: Grup-batalioni i Këmbësorisë së Lehtë, rritja e aftësive të Mbrojtjes Kibernetike, projekti i helikopterëve shumërolësh "Black Hawk", etj.

Gjenerale Shehu, falënderoi znj. Sandy LONG për ndihmën dhe mbështetjen e pakursyer që SHBA-të, i kanë dhënë FARSH-ve.



Në takimin me gjenerallejtënant Laura Potter, drejtore e Shtabit të Forcave të Armatosura në Pentagon

Takimi u fokusua kryesisht në historinë e marrëdhënieve dypalëshe SHBA - Shqipëri, mbështetja dhe kontributi i çmuar që SHBA-ja i ka dhënë Shqipërisë gjatë gjithë procesit të demokratizimit të vendit dhe veçanërisht të transformimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura nëpërmjet ekipeve, ekspertëve dhe zyrës së ODC në Tiranë.

Gjithashtu u diskutua për rolin e femrës në Forcat e Armatosura, mbi rezolutën 1325 të OKB "Women Peace and Security".

Gjenerale Shehu së bashku me personalitet që e pritën në takime, vunë në dukje bashkëpunimin e shkëlqyer mes dy vendeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, vlerësuan ndihmën e dhënë nga SHBA në fushën e arsimimit, trajnimit, stërvitjeve dhe pjesëmarrjes në misione të përbashkëta, mbështetjes logjistike, kibernetike, modernizimit të FA-së dhe rritjen e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen në dobi të paqes e sigurisë në Rajonin e Ballkanit dhe atë globale dhe në modernizimin e Forcave të Armatosura.

Si përfundim vizita ishte shumë e suksesshme dhe i shërben rritjes dhe forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve të shkëlqyera mes dy vendeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

KLO, vizitë në verilindje të vendit

Kursantët e kursit të Lartë të Oficerit (KLO) nën drejtimin e Departamentit të Strategjisë dhe Studimeve të Avancuara (DSSA), zhvilluan vizitë studimore historike në pjesën verilindore të vendit tonë.

Pjesëmarrësit e kursit të lartë të oficerit (KLO), u njohën me rëndësinë e zhvillimeve të betejës së Gjoricës dhe Sinjës si dhe zhvillimet historike në Kalanë e Dodës dhe në Qafën e Kolosjanit.

Më tej vizita vazhdoi në Grykën e Morinit, ku u realizua përshkrim i përgjithshëm i rajonit dhe periudhat kryesore historike që lidhen me këtë rajon, betejat kundër pushtuesve në fshatin Pobreg dhe Grykën e Morinit.

Pjesë e programit ishte dhe vizita në Bashkinë Krumë dhe me pas vizitë në Grykën e Vlahnes dhe Qafën e Prushit, ku u shpjegua mbi rëndësinë e këtyre grykave sidomos gjatë aktiviteteve për mbështetjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Në vijim u realizua vizitë në qytetin e Tropojës, ku stafi pedagogjik dhe kursantët u pritën në takim nga Kryetari i Bashkisë z. Rexh Byberi. Gjatë takimit ndër të tjera u diskutua mbi bashkëpunimin e Bashkisë Tropojë me njësitë e Forcave tona të Armatosura në kuadrin e realizimit të projekteve për përmirësimin e jetës së banorëve dhe për shfrytëzimin



e potencialeve të mëdha të zonës në fushën e turizmit. Vizita mësimore me kursin e KLO-së u monitorua gjatë gjithë kohës nga Departamenti i Strategjisë dhe Studimeve të Avancuara (DSSA),

si dhe u ndoq nga komandanti i Kurseve nënkolonel Luli Florini dhe komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj.

3 dimensionet e familjes së një ushtaraku

Në përditshmërinë e punës time, më duhet të takoj njerëz të ndryshëm në profesion, mentalitet, formim akademik, etj. Ajo që prej kohësh më jep emocion dhe më bën të besoj tek integriteti i familjes shqiptare, normave dhe vlerave morale, është njohja e familjeve ushtarake, ku partnerët aderojnë prej vitesh në Forcat e Armatosura të Ushtrisë Shqiptare. Të përkushtuar në misionin e tyre, me kujdesin e prindërve, në edukimin e qytetarëve të ardhshëm, janë dhe bashkëshortët Flora dhe Artan Dako, prindër të tre fëmijëve Joralda, Rozeta dhe Krisel.

Një familje e bukur, e realizuar, por që pa diskutim ka patur sfidat e veta, të cilat së bashku ja kanë dalë.

Flora, ashtu si të gjitha gratë shqiptare me ngarkesat e profesionit, dëshirën për t'u kualifikuar, të qenit bashkëshorte, nënë, ja del falë dhe mbështetjes së saj më të madhe, Artanit, i cili ka mbaruar gjithashtu Akademinë Ushtarake "Skënderbej", dega "Zbulim".



Sot Flora mban gradën nënkolonel.

Nënkolonel Flora (Ceraj) Dako ka lindur më 25 prill 1971, në Vaun e Dejës dhe është rritur në Velipojë, Shkodër. Ajo vjen nga një familje Mirditore me tradita dhe është fëmija i gjashtë, nga shtatë fëmijët e familjes Ceraj.

Shkollën e mesme Flora e ka mbaruar në shkollën "Nikoll Zagorjani" në Velipojë, me rezultate të shkëlqyera.

Gjatë shkollës së mesme, zhvilloheshin kurset dyjavore ushtarake, dhe nga këtu Florës i lindi dëshira e uniformës dhe e shërbimit në uniformë. Pas përfundimit të shkollës së mesme, në vitin 1989, Flora aplikoi për ndjekjen e Akademisë Ushtarake "Skënderbej". Në rrethin e Shkodrës ishte vetëm një bursë e tillë për femra, dhe ajo që e fitoi ishte Flora. Dëshira e saj u realizua, por ajo nuk fsheh dot lumturinë e prindërve të saj dhe sidomos të babait të saj, Markut, i cili kishte dëshirë po aq të madhe sa Flora që ajo të vazhdonte shkollën ushtarake.



Nga viti 1989 deri në vitin 1993 Flora mbaroi Akademinë Ushtarake në degën "Plan-Financë". Nuk ishte aspak e lehtë për Florën të përshtatej me një jetë ushtarake, por dëshira dhe vlerat e saj e bënë që të punonte me përkushtim e disiplinë të lartë gjatë katër viteve të shkollës.

Pas përfundimit të Akademisë, Flora emërohet në Brigadën e Këmbësorisë, Berat, si shef i shërbimit të veshmbathjes dhe ushqimit, e më pas duke kaluar si shef i Degës së Financës së kësaj komande deri në vitin 2001, ku transferohet në repartin e Policisë Ushtarake, Tiranë, si Shef Finance. Në këtë repart dhe në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (e porsa krijuar) Flora shërbeu për një periudhë të shkurtër, dhe në janar të vitit 2003, ajo emërohet në



Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, si Specialist në Sektorin e Buxhetit të kësaj drejtorie. Nga viti 2006-2009 Flora, duke patur një performancë dhe korrektësi të madhe në punën dhe kontributin e saj, u emërua shef i Sektorit të Buxhetit në këtë drejtori (J8). Pra, siç e shikojmë, karriera e Florës është e larmishme dhe e arritur shkallë-shkallë si në pozicione pune, ashtu dhe në gradë. Pas mbarimit të kursit themelor të oficerit, Flora promovohet në gradën e "majorit" në vitin 2006.

Në vitin 2009-2010 Flora mbaron Kursin e Komandës e Shtabit të Përgjithshëm pranë Akademisë së Mbrojtjes, me rezultate të larta.

Po këtë vit Flora promovohet me gradën e "nënkolonelit" dhe emërohet shef i Degës së Programim-Buxhetimit (G8) në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, duke kaluar më tej si shef i Degës së Planifikimit po në këtë komandë, deri në emërimin e saj në Përfaqësinë Ushtarake të Shqipërisë në NATO si Oficer për Financën dhe Protokollin, nga korriku i vitit 2012 deri në korrik 2015.

Kontributi dhe eksperiencia duke shërbyer në këtë institucion ka qenë maksimale dhe e vlerësuar jo vetëm nga Ministria e Mbrojtjes, por dhe nga homologët tanë në NATO. Flora përfaqësonte Shqipërinë në takimet javore të grupit të punës së Buxhetit & Logjistikës që organizoheshin në NATO, duke qenë shumë aktive dhe e vlerësuar nga kolegët e saj ndërkombëtarë. Nga korriku 2015 deri në tetor 2016, Flora ka kryer

detyrën e Përgjegjësit të Sektorit të Programimit dhe Analizës dhe njëkohësisht zëvendësudrejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes (J5/8) në SHPPA. Në tetor të vitit 2017 Flora fillon Kursin e Lartë të Oficerit pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, të cilin e mbaroi me rezultate të larta. Nga dhjetori 2017 deri në qershor 2018, Flora ka shërbyer me korrektësi e dinjitet në KFOR, Kosovë, në Grupin e Bashkuar Logjistik (JLSG) si Shef Shtabi i këtij grupi. Aftësitë e saj komunikuese dhe drejtuese të shtabit prej 35 vetave nga 15 vende të ndryshme të kësaj komande, tregohet qartë dhe në vlerësimin "Shkëlqyeshëm" i bërë nga komandanti i KFOR-it.

Në vitin 2022 sfidon veten me pjesëmarrjen e saj në misionin

e KFOR-it, por këtë radhë si zëvendëskomandante e Komandës Rajonale Perëndimore me dislokim në Pejë. Ky ishte përfaqësimi i parë për Shqipërinë në këtë pozicion, dhe Flora shtroi rrugën për pasuesit e saj në këtë pozicion. Punën e saj dhe vlerësimin e tregojnë edhe vlerësimet e eprorëve të saj në mision.

Pjesë e pandarë e karrierës së Florës kanë qenë dhe kërkesat personale të saj për edukim të mëtejshëm.

Në vitin 2003 Flora ka kryer kursin e Oficerit të Financës në SHBA, me rezultate të larta (Academic Excellence); në vitin 2007 ka kryer Kursin Ndërkombëtar të Oficerit të Shtabit në Holandë dhe Kursin Ndërkombëtar të Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes në SHBA; në vitin 2008 ka kryer Kursin Ndërkombëtar të Partneritetit për Paqe; në vitin 2009 ka kryer Studimet Pasuniversitare në Marrëdhënie Ndërkombëtare në Akademinë Diplomatike në Tiranë; Në vitin 2012 ka kryer Kursin e Lartë të Sigurisë në Gjermani.

Në vitin 2009-2011 Flora ka mbaruar Masterin Shkencor në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, në Degën Administrim Publik, me rezultate të larta dhe aktualisht është Doktorante pranë Akademisë së Forcave të Armatosura.

Nënkolonel Flora Dako ka mbrojtur gjuhët e huaja Anglisht dhe Italisht, si dhe flet Greqishten dhe Frëngjishten mirë.

Nënkolonel Dako është nderuar me tetë medalje, nga të cilat: dy medalje "NATO Balcans Medal" nga Komandanti i KFOR-it, Kosovë, me medalje të "Kryqit Përkujtimor" nga Ministria e Mbrojtjes Italiane, "Medaljen e Luftëtarit" nga SHPPA, si dhe me medalje shërbimi e karriere.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Me vite rritemi, mençurohemi dhe në përballje me sfidat që na sjell jeta kuptojmë që si të mbash një orë që kushton 300 dollarë apo të mbash një orë që kushton 30 dollarë, ato të dyja tregojnë të njëjtën kohë. Pavarësisht nëse mbajmë një portofol prej 300 dollarësh apo mbajmë një portofol 30 dollarësh, shuma e parave brenda është e njëjtë. Pavarësisht nëse ngasim një makinë 150 000 dollarë ose një makinë 30 000 dollarë, do të arrijmë në të njëjtin destinacion.

Jemi në ditët e fillimit të verës dhe njëkohësisht të festës, ku të rinjtë tanë maturantë celebroidin fundin e një udhëtimi të gjatë dhe sfidues, për t’u përballur me sfida të reja. Dhe padyshim kjo festë do përgatitet e saj. Dyqanet gumëzhijnë nga zërat e vajzave dhe djelmohave të rinj, të cilët të shoqëruar nga prindërit shpesh ngrënë zërin në formë revolte përballë pamundësisë financiare për të blerë veshjet e ‘luksit’ që ata duan.

Çfarë po ndodh me të rinjtë tanë? Mos gabimi qëndron tek mos prindërimi ynë?!

Shpesh të rriturit akuzat e dështimit të raporteve morale të shoqërisë i hedhin tek të tretët shkollës, shoqërisë jashtë trungut familjarë, pa e drejtuar fillimisht gishtin tek vetja.

Prindër, mos i edukoni fëmijët tuaj të jenë të pasur!

Edukojini ata të jenë të lumtur. Kështu që kur të rriten do të dinë vlerën e gjërave dhe jo çmimin e tyre. Konsumojeni ushqimin sikur të ishte ilaçi juaj, përndryshe një ditë do të jeni të detyruar që të hani ilaçin si ushqimin tuaj. Ata që ju duan nuk do t’ju lënë kurrë. Edhe nëse ka njëqind arsye për të hequr dorë nga ty, ata do të gjejnë një arsye për të qëndruar me ty. Ekziston një ndryshim i madh midis të qenit njeri dhe një qenie njerëzore, dhe jo të gjithë e kuptojnë këtë. Nëse doni të ecni shpejt, shkoni vetëm, nëse doni të shkoni larg, shkoni së bashku.

Njerëz të ndryshëm ndajnë eksperiencën të ndryshme, por fundi i këtij udhëtimi është realiteti ku jetojmë, realiteti ku po rritet një brez i ri, motoja e të cilit është “çfarë marke e ke bluzën, atletet, fustanin...?”, dhe pas kësaj ose një zgurdullim sysh nga habia, ose një zgërdhirje dhëmbësh pikërisht për ‘nivelein’ e veshjes nga tjetri, përballë.

Duhet të ndalemi të gjithë e të shohim qartë çfarë po ndodh. Mos të trembemi, por të rrisim vigjilencën.

Mësuesi dhe prindi duhet të jenë në gjendje alarmi. Shkolla të reagojë shpejt, shoqëria ta qepë gojën, media të japë modele...

Bota në kohët e fundit ka filluar të tërhiqet më shumë nga aparencia dhe fizionomia e jashtme. Vlera e njeriut sot fillon me pamjen e tij të jashtme. Kjo është diçka normale, duke ditur që globalizmi që po shtrihet kudo është globalizëm i aparencës.

Shumë nga problemet familjare mes prindërve dhe fëmijëve, lindin për shkak të aparencës dhe pamjes së jashtme.

A mund të themi se shumica e të rinjve tanë i mbajnë sytë nga moda dhe se kjo ndodh për faktin e zbrazëtirës së brendshme?

A mund të konsiderohet kjo si një varfëri kulturore?

A është e vërtetë se në raste dobësie, njeriu i mban sytë nga këto dukuri?”

Disa të rinj veshin rroba femrash, duke dashur të përngjasojnë me to. Kur i pyet mbi këtë, të përgjigjen se është e modës. Nuk e di se si e konceptojnë modën të rinjtë e sotëm?!, u japim rastin që të gjejnë një arsye dhe justifikim për këtë. Ne sot kemi nevojë që t’u paraprijmë justifikimeve. Nëse ne e dimë se po i pyetëm, përgjigja dhe justifikimi i tyre do të jetë “Moda”.

Është më e favorshme që të fitojmë simpatinë e të riut, sesa ta korrigjojmë dhe qortojmë. Një rregull thotë: “Të fitosh simpatinë e dikujt është më e vlefshme se të fitosh debatin me të”. Duke fituar simpatinë e dikujt, unë kam fituar dhe debatin mbi një çështje të caktuar. Ne duhet ta kemi të qartë që adoleshentët e kanë në majë të gjuhës përgjigjen dhe tentativat për të depërtuar në brendësinë e tyre në mënyrë direkte, nuk do të japë asnjë rezultat.

Të rinjtë dhe raporti i tyre me realitetin e kushteve ekonomike-sociale nga vijnë

Ata kanë pak para, por shije të shtrenjta. Vlerësojnë rehatinë dhe ndërgjegjen sociale. Duan që blerjet të jenë të lehta dhe t’u përshtaten nevojave personale.

Dëshirojnë autenticitetin ndërsa janë të zhytur vazhdimisht në

Të rinjtë shqiptarë dhe ‘çmimi’ i jetës së luksit



një botë dixhitale. Ndërsa të rinjtë po fillojnë të shpenzojnë me zell, markat po përipiqen të kuptojnë se çfarë duan ata dhe si blejnë. Përgjigjet do të përcaktojnë epokën e ardhshme të konsumit.

Shifrat totale janë të frikshme. Bashkimi Europian është shtëpia e gati 125 milionë njerëzve midis moshës 10 dhe 34 vjeç (më i riu do të bëhet konsumator në vitet e ardhshme). Amerika ka 110 milionë persona të brezave “Generation Z” (10 deri në 26 vjeç), sa një e treta e popullsisë.

Zakonet e blerjeve të të rinjve, ashtu si jeta e tyre, përcaktohen nga “ekonomia e vëmendjes”, blerja e gjërave në internet është shumë më e shpejtë dhe më e lehtë sesa të shkosh në dyqan.

Falë përhapjes së mediave sociale, ka shumë mënyra të reja për të tërhequr syrin e konsumatorëve. Blerësit e rinj nuk kanë njohur kurrë një botë pa celularë smartphone. Pritshmëria për rritjen e komoditetit shoqërohet me rritjen e popullaritetit të bizneseve që gëzojnë reputacion me emrin e markës së tyre...

Të rinjtë duan që blerjet e tyre të jenë krejt të lehta

Videot e krijuara nga përdoruesit e “TikTok” mund të nxisin edhe markat e vogla drejt famës së shpejtë virale. Aplikacione të tilla po shtojnë gjithnjë e më shumë veçori që i lejojnë përdoruesit të blejnë pa u larguar fare nga platforma. Bota e re e blerjeve i ka lejuar gjithashtu të rinjtë të jenë më të informuar për kompanitë ku blejnë. Mbingarkesa e informacionit nuk i ka zbehur ndjenjat e të rinjve, por duket se i ka bërë ata tepër të ndjeshëm, veçanërisht ndaj çdo marke që pretendon se është diçka që nuk është.

Në një botë ku imazhi dhe prezantimi janë të rëndësishëm, markat e njohura janë të pranishme si simbole të statusit dhe suksesit

Përplasja midis rritjes së koston dhe dëshirës për marka të

njohura sjell me vete edhe sfida të tjera. Ka një aspekt financiar, pasi për një numër të madh njerëzish, blerja e produkteve të markave të njohura mund të jetë një shpenzim që zë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit, duke sjellë sfida të vërteta për mbijetesën. Por sa merret kjo në konsideratë nga të rinjtë sot?

A “është turp të jesh i varfër”?

Tek fëmijët apo të rinjtë ndihet dukshëm investimi te pamja e jashtme, prindërit, duke qenë se kanë kaluar vetë një fëmijëri me shumë mangësi, priren t’ua plotësojnë kërkesat fëmijëve, duke hequr nga vetja apo duke lënë gjëra të tjera edhe më të nevojshme.

Të rinjtë marrin mesazhin se nëse je dukshëm i pasur, të tjerët të respektojnë më shumë dhe rriten prestigji. Megjithatë kjo në shumicën e rasteve realizohet me marka false apo ekzagjerime në veshje, të cilat tërheqin vëmendjen, por që nuk lidhen dukshëm me atë që ka brenda vetes personi.

Sado që të vishen këta persona, imitojnë apo ndriçojnë me bizhuteritë e tyre në publik, do vijë momenti kur do të përplasen me realitetin.

Jeta e secilit prej nesh zhvillohet në rrethana nga më të ndryshmet. Kjo e bën ritmin e saj dhe të përditshmen të ndryshme po aq sa dhe të sfiduese. Të lindësh në pamundësi dhe në përpjekje të vazhdueshme për të plotësuar nevojat bazë. Ndërsa vjen një çast kur ndryshon gjithçka dhe ke para syve jetën që ke dëshiruar. Njerëz, rrethana, momente, mosdorëzim që ndryshojnë drejtimin e jetës tënde dhe ke çfarë gjithnjë ke dashur. Por a e kthejmë kokën pas për të mos harruar çfarë ishim?!

Të jesh i ‘varfër’ moralisht, shpirtërisht, po, është shumë e turpshme.

Nga lufta në paqe: 12 qershor 1999 - 12 qershor 2024

25 vjet më parë, më 12 qershor 1999, trupat paqeruajtëse të NATO-s hynë në Kosovë pas një fushate ajrore 78-ditëshe kundër pozicioneve ushtarake e policore serbe. Me futjen e trupave të NATO-s në Kosovë iu dha fund luftës së nisur në vitin 1998, mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave serbe.

Hyrja e trupave të NATO-s u bë pas Marrëveshjes së Kumanovës, e cila u arrit më 09.06.1999, ndërmjet zyrtarëve serbë dhe autoriteteve të NATO-s, të udhëhequra në atë kohë nga gjenerali britanik, Mike Jackson. Me këtë marrëveshje, Serbia pranonte kapitullimin dhe detyrohej t'i tërhiqte të gjitha forcat policore dhe ushtarake nga Kosova.

25 vjet nga ajo ditë, misioni i NATO-s, KFOR-i, vazhdon të menaxhojë situatën e sigurisë, si në jug, ashtu edhe në veri të Kosovës.

Pas çlirimit të Kosovës u nënshkrua marrëveshja për demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe në shtator 1999, u themeluan Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), si forcë jo ushtarake, por si forcë reaguese në rast të katastrofave natyrore.

Nëntë vjet më vonë, më 17 shkurt 2008, Kosova u shpall shtet i pavarur.



12 qershor 1999: Në këtë fotografi të shkrepur më 12 korrik në qytetin e Kaçanikut në jug të Kosovës, shihen ushtarët britanikë, ndërsa me helikopterë zbresin mbi një urë për të siguruar atë për arritjen e trupave të tjera të NATO-s. Qindra trupa britanike, përfshirë ata elitare Gurkha, të njëjtën ditë vazhduan rrugën drejt Prishtinës.

12 qershor 2024: Vendi ku është shkrepur kjo fotografi nuk ka ndryshuar shumë as 25 vjet pas. Aty vërehet zgjerimi i rrugës dhe anësoret mbi urë. Disa shtëpi dhe objekte tjera janë ndërtuar ndër vite, si dhe një rrugë është asfaltuar.



12 qershor 1999: Ushtarët britanikë ndërsa shikojnë një objekt banimi kolektiv duke u djegur në Prishtinë. Sipas përshkrimit të fotografisë nga Reuters, kjo fotografi është shkrepur pak kohë pasi trupat britanike ishin sulmuar me armë zjarri nga një pjesëtar i ushtrisë serbe.

12 qershor 2024: Përgjatë viteve shihet se në këtë lokacion është ndërtuar një objekt shkollor, si dhe janë vendosur rrethoja pas zgjerimit të rrugës. Shumë objekte të tjera për banim kolektiv janë ndërtuar në 15 vjetët e fundit.



12 qershor 1999: Forcat e KFOR-it arritën në Podujevë disa ditë më vonë se në qytetet tjera të Kosovës. Në këtë fotografi shihen fëmijët duke vrapuar pranë një tanku ndërsa përshëndesin ushtarët britanikë, të cilët sapo kishin arritur në qytet.



12 qershor 2024: Njëzetepesë vjet pas, në të njëjtin vend objekti komunal mbetet thuasë i njëjtë. Sheshi kryesor është zgjeruar dhe janë ndërtuar objekte të reja.

12 qershor 1999: Një ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kalon pranë një tanku gjerman më 15 qershor të vitit 1999. Trupat e UÇK-së marshuan në këtë qytet pas largimit të një konvoji të gjatë të civilëve dhe policëve serbë nga Prizreni.



12 qershor 2024: Njëzetepesë vjet pas kësaj dite, në të njëjtin vend shihet objekti i përfunduar i hotelit “Theranda”.



12 korrik 1999: Mijëra qytetarë kishin dalë këtë ditë në qendër të qytetit në Rahovec në ditën e katërt të protestës kundër një dislokimi të mundshëm të trupave paqeruajtëse ruse. Qytetarët shqiptarë të Rahovecit kishin protestuar për disa ditë duke thënë se paraushtarakët rusë kishin marrë pjesë në dhunën serbe kundër tyre.

12 qershor 2024: Përveçse është zvogëluar hapësira e sheshit, xhamia është rrënuar dhe është ndërtuar një e re. Disa objekte që shihen para 25 vjetësh ende janë aty, vetëm se kanë pamje tjetër të jashtme.

Gëzuar Kosovë!





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ,
(Mjeshtëri i Madh)

Familja Murati në Memoraq

Familja Murati historikisht ka qenë një familje me tradita luftarake. Ndonëse me gjendje jo të mirë ekonomike, Muratajt financonin ndërtime të tilla me vlerë shoqërore dhe kulturore afër vendbanimeve të tyre. Ata qenë nikoqirë të zotë, bujarë, mikpritës, punëtorë të mirë, blegtorë dhe bujq të shquar. Muratajt pas disa lëvizjeve të diktuar nga kushtet e kohëve, u vendosën përfundimisht në Memoraq të Finiqit.

Kiço Murati, i biri i Stavros dhe i Lenës, ishte një burrë i rrallë në krahinë. Ishte i pashëm, serioz, i sinqertë, i ndershëm dhe besnik. Ishte i pashkollë, sa rrokjezonte dhe hidhte ndonjë firmë. Megjithatë, veç greqishtes, fliste turqisht dhe në mënyrë të përsosur shqip. Ishte mjaft i zgjuar dhe nikoqir. Donte shumë prindërit dhe gjyshërit e tij. Ai merrej me bagëti dhe pemëtari, se tokë buke nuk kishin.

Memoraqi kishte fare pak toka, pa ujë për vaditje. Kiço ishte mjeshtëri në pemëtari, në krasitje dhe shartime. Nga duart e tij të arta është bërë blloku i ullinjve rrëzë kodrës ku ishin shtëpitë e para të Muratajve. Fillimisht, kur erdhën nga Palo-Memoraqi, por të detyruar nga çifligarët u ngjiten 200-250 m më lart. Kiço Murati u nda nga jeta në prill 1936, kur ishte 65 vjeç. Familja e tij, si gjithë familjet e Memoraqit, ishte e varfër. Muratajt jetonim nga halli të tërë bashkë, tri familje, njëzet e nëntë frymë. Shtëpia ku banonin në fshat ishte shumë e vogël, 3.5 m x 3.5 m plus një kuzhinë-furrë me hyrje nga jashtë. Flinin përdhe në rogoz gjineshtre njëfillëshe, mbuluar me velenxa.

Pak para që kishte mbledhur Kiço me kursime dhe sakrifica të mëdha në llogarinë e përbashkët të familjes, për të ngritur të paktën dy shtëpi të reja, i humbën me falimentimin e bankës së Korfuzit, kur plasi kriza ekonomike botërore e viteve 1929, 1939-1940. Në të tilla kushte fukarallëku u rrit dhe u edukua Vasili, në varfëri të plotë dhe të padurueshme. Nëna Zoica, ishte njeriu që ndikoi më shumë në formimin e karakterit burrëror të Vasilit. Ajo ishte kurdoherë pranë fëmijëve.

Që në rini shkëlqeu guximi i Vasilit

Vasil Murati lindi, më 10 tetor 1922 në Memoraq. Ndoqi shkollën me shumë sakrifica të mëdha. Në vjeshtë të vitit 1940, një akt kurajimi i dha emër djaloshit të ri, Vasil Muratit. Bejlerët e livadheve dhe qehallarët e tyre, u kërkonin në vjeshtë blegtorëve për së dyti taksa për livadhet. Pas shumë presionesh, një pasdite vjeshte, ata me sejmën vërkollakun nga pas, shkuan që të përzënë kopenë me armë nga kullota e barinjve pleq, se kishin gjetur një vllah myshteri që u jepte më shumë para. Me të dëgjuar pushkët, Vasili rrëmbëu armën dhe u doli në krahë barinjve të fshatit. Për pak minuta, aty vrapuan edhe papo Nashua me papo Kostën, Jorgo Murati, Koçi Baxhaqi, Migo Baxhaqi, Panajot Vaso, Miço Karadano, Jori Miho dhe gjithë burrat që mbanin armë në fshat, u bënë mbështetje e djaloshit guximtar dhe të plakut trim Nasho Murati. Qehallarët ia mbathën vrapit dhe nuk u dukën më në ato anë. Pas këtij akti i gjithë fshati u bë njësh, grusht i bashkuar, siç qe edhe para disa viteve në rastin kur Memoraqi, i pari në Vurg protestoi kundër grabitjes së tokave të tyre. Ky akt i djaloshit trim e guximtar bëri që fshatarët të bashkohen dhe të reagonin kundër së keqes së përbashkët. Burrat e fshatit për herë të parë u bënë bashkë dhe e kuptuan të mirën që sjell reagimi i përbashkët si në grevat e kohës së Zogut, dy herë në Sopik gjithë fshati i Memoraqit i përkrahu.

Me pak para dhe shumë punë për mbledhjen e materialeve të ndërtimeve, gurit, rrës trarëve, gëlqeres, etj., u bë e mundur të ndërtohej një shtëpi e re e vogël, pa mur ndarës në mes, e cila iu dha papo Nashos se kishte familjen me fëmijë të vegjël. Kështu propozoi Vasili dhe këtë e pranuan të gjithë. Fjala e tij kishte peshë në familjen Murataj. Vasili ishte dhe njeri i sakrificës dhe i punës. Një të diel, dite pazari, një grup fshatarësh nga Memoraqi shkuan në Delvinë, për të shitur prodhimet e tyre. Lumi i Bistricës kalonte poshtë Velahovës, ku kalon Urë-kanali i vijës ujëtase “Thoma Filipeu”. Lumi kishte shumë ujë dhe urë nuk kishte. E gjora Vasillo, ngarkuar me 30 kg grurë e mori vala e lumit dhe rrezikojë të mbytej. Vasili 15-16 vjeçar hodhi mallin e vet në lumë dhe u lëshua me not dhe e shpëtoi...

Fillimi i lëvizjes antifashiste

Pushtimi fashist e preku thellë në shpirt Vasil Muratin, djaloshin e ri 17 vjeçar. Dëgjoi dhe lexoi në shtyp e trakte për qëndresën heroike të Mujo Ulqinakut me shokë, në Durrës, apo të Mitro Dhimërtikës me shokë në Sarandë. Në çështjen atdhetare Vasili kishte pjekuri. Urrejtje të veçantë kishte për ata që regjistroheshin në organizatën e Balilasve. Gjendja e mjerueshme e detyroi të futej punëtor në Botore për hapje rrugësh dhe ndërtim urash për automjetet e fashizmit. Një punë pa dëshirë, por tjetër zgjidhje nuk kishte. Rrugët në vetvete i shihnte si një zhvillim e përparim për vendin, paçka se ato për momentin ndërtoheshin për t’i shërbyer fashizmit. Punoi në Delvinë, Muzinë, Bogaz e Konispol, në Qafëbotë e Sarandë.

Mes vështirësish dhe sakrificash po rritej dhe burrërohej përditë. Vasili u formua e u kalit si i ri patriot e revolucionar e më pas, nën ndikimin e Lefter Talos, edhe si komunist. Në prag të pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, Lefteri ishte transferuar si mësues në fshatrat e Dropullit. Aty e zuri pushtimi dhe aty u lidh me lëvizjen. Për rrjedhojë, andej qenë edhe njohjet e para me aktivistë të Lëvizjes. Kur e arrestuan fashistët dhe e burgosën në kalanë e Gjirokastrës,

Antifashisti Vasil Murati, shembull për minoritetin



shokë burgu Lefteri kishte Rita Markon dhe Shefqet Peçin, të lidhur me lëvizjen çlirimtare. Këto kontakte Lefteri ia bëri të njohura dhe Vasil Muratit, i cili pas pune lexonte çdo ditë me orë të tëra. Lexonte libra e broshura të ndryshme që i gjente nga shokët më të shkolluar e më të përparuar në lëvizjen antifashiste. Kishte etje të madhe për dije. Duke u rritur filloi të lexojë edhe më shumë libra historikë, politikë, broshura ideologjike mbi njohuritë fillestare për Marksizmin dhe Leninin, për Bashkimin Sovjetik të Stalinit të madh, dhe mendja e tij ëndërrimtare fluturonte në të ardhmen e lumtur të vendit të tij, por, para së gjithash, duhej dëbuar bisha fashiste nga Atdheu.

Këtë frymë të re, Vasili e solli edhe në fshat, i kultivoi atij frymën e klasës punëtore, solidaritetin, internacionalizmin, humanizmin, unitetin. Shokët më të avancuar në lëvizjen e Rinisë Komuniste vunë re besnikërinë e tij, dashurinë për shokët, frymën e kolektivitetit, përpjekjet për dije e kulturë më të gjerë, trimërinë, guximin etj. Për këto e të tjera cilësi e tërhoqën në grupin e Rinisë Komuniste të portit, në qytetin e Sarandës. Thirrjet në takime e biseda, merrte pjesë në aksionet fillestare, dhe, gradualisht u organizua në njërin nga më të përparuarit e këtij grupi. Por puna nuk qe e përhershme dhe shpesh këto celula shpërbëheshin. Lidhjet e reja bëheshin me vështirësi. Këtu ai punoi nga fillimi i verës së vitit 1939 deri në fund të tetorit 1940. Në portin e Limjonit punoi për 18 muaj, ku mësoi dhe italishten dhe u njoh me shokë punëtorë nga Saranda, Muzina, Grazhdani, Bregdeti, Çamëria, Labëria etj. Ai njoh dhe bashkëpunoi me të rinj komunistë si Mitro Xhani, Mitrojorgjët, Javer Malon, B. Sinoimerin, si dhe me shokë Myslim Mamacen, Thoma Lulon, Ballacët, K. Haxhiun, Çuçajt, etj. Vasili u arrestua dhe u dënua me burg nga gjyqi fashist për marrje armësh dhe municioni. Në port njohu dhe dy komunistë italianë të cilët krijuan lidhje dhe kur kapitulloi Italia, Domenico doli partizan dhe u bë komandant i batalionit vullnetar italian “Mateoti”.

Kur u krijua partia, Vasili ishte 19 vjeçar. Shpresa e shpëtimit nga fashizmi dhe nga bejlerët e agallarët iu shumëfishua. Delvina, kur u themelua PKSH, kishte një bërthamë prej trembëdhjetë komunistësh, por edhe mjaft të rinj komunistë ilegalë, një ndër të cilët ishte dhe Vasili. Ndjekjet e vazhdueshme për një kohë të gjatë, e bënë atë më të fortë e më të vendosur. Ndërkohë Vasil Murati, propagandonte programin e PKSH-së, thirrjet e proklamatat e saj, për të ndërgjegjësuar e ngritur të gjithë popullin në luftë për liri e për një pushtet të ri popullor. Ai njohu dhe mbante kontakte me Mihal Bishën, B. Sinoimerin, Fejzo Mehmetin, M. Mamacën, me Malot, Ballacët, Çuçajt, Mitrojorgjët, K. Haxhiun, S. Lenkon, V. Pandon, Lefter Talon, Mitro Xhanin, Q. Dhrosen, (Kasiani) Talon, Vaso Zhupën, Ilia Skaperën etj. Vasili kontakte partie kishte me Muzafer Asqeriu, Lenka Vasin, Jorgo Zhupën, Miho Xhanin, Jorgo Ferron, etj. Mbante lidhje edhe me mësuesit Miltjadh Apostolidhi, Minella Polo, Minella Dalanin, etj.

Familja Murati dhe Vasili në luftë

Qysh në fillim të Luftës Antifashiste familja Murati u lidh me Luftën Nacionalçlirimtare, duke i dhënë përkrahjen e plotë Lëvizjes Antifashiste dhe Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar të udhëhequr nga PKSH-ja. Për këtë qëndrim mbi familjen Murati, ballistët dhe zervistët shkarkuan gjithë egërsinë ndaj tyre dhe gjithë fshatit

Memoraq. Thoma Murati, vëllai i madh i Vasilit, kryente detyrën e përgjegjës politik të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të fshatit, anëtar i Krahinorit e më pas nënkryetar i tij. Mihali, vëllai i vogël i Vasilit, ishte ngarkuar me detyrën e përgjegjës të celulës së organizatës së rinisë komuniste, të përbashkët për fshatrat Memoraq, Dermish, Rumanxa e Ymerafend (sot Fitore). Motra e Vasilit, Alekso Rubati, e kishte burrin, Foto Rubati, me çetën partizane të Rrëzës. Ndërsa i kunati Jorgo ishte kryetar i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Mesopotamit.

Gjatë viteve 1942-1943 Vasili mendohej t’i bindte njerëzit dhe t’i tërhoqte në luftë në krahun e Frontit. Mbledhja e Çakallos e fillim shtatorit 1943, pas mbledhjes së 8 gushtit në Vigëll dhe asaj të Konispolit të 10 gushtit, ishte e treta e radhës, po aq të rëndësishme sa ato të parat. Këtu përfundimisht u vendos triumfi i vijës së Partisë në minoritet. Mjaft nga pjesëmarrësit u bindën dhe u rreshtuan në anën e Frontit Nacionalçlirimtar, disa dolën partizanë, luftuan trimërisht dhe marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe minoritetit ishin raporte miqësie, respekti reciprok kombëtar e fetar, shkëmbim vlerash kulturore e shpirtërore.

Vasili punoi në Sarandë, Delvinë dhe në Dhrovjan-Muzinë-Leshnicë-Theollogo-Vurg si aktivist i rinisë dhe mori pjesë në takimet e Gjirokastrës dhe të Delvinës me Qemal Stafën, në prill 1942. Punoi dhe ngriti celulën e parë komuniste në Dhivrit dhe në Delvinë. Vasil Murati mori pjesë në aksionet e njësiteve guerile në rreth për prerjen e linjave telefonike, në pritën e parë në Qafë Muzinë, në ngritjen e organizatës së rinisë dhe të komitetit antifashist në Delvinë në dhjetor 1942 - shkurt 1943. Me njësitin gueril dhe me çetën “Çamëria”, më 12 shkurt 1943, mori pjesë në operacionin për çarmatosjen e postave të financës në Zimnec, Leshnicë dhe Karroq.

Për dy muaj Vasili ishte në ndihmë të çetës partizane të Lunxhit, qëndroi me Themo Vasin dhe ngritën në zonë këshillat antifashiste, organizatën e frontit, të rinisë dhe të gruas. Mori pjesë në formimin e çetës “Çamëria”, më 2 shkurt 1944, dhe iu bashkua kësaj me njësitin e tij. Më 19 mars 1943, ngarkohet nga qarkori i partisë në Gjirokastër, prej Haki Toskës për ngritjen e organeve të informimit partizan, si dhe u caktua përgjegjës për marrëdhëniet me PK Greke, pasi njihte mjaft nga luftëtarët dhe drejtuesit e ELLAS-it.

Vasili mori pjesë në betejën 55 ditore të luftës së Konispolit, duke qenë dhe kuadër i informacionit partizan dhe të shtabit të Grupit të IV Partizan. Në betejën e Qafës së Gjashtës më 20-22 shkurt 1944, Vasili me një togë partizane luftoi me mjaft forca të armatosura gjermane-balliste, u plagos, por nuk e lëshoi pozicionin. Vasili u plagos përsëri kur luftonte me batalioni “Pandeli Boçari”, si dhe më 29 mars 1944, në Dhivër nga një predhë mortaje. Vasil Murati mori pjesë në luftën për çlirimin e Delvinës në korrik 1944, aty pa të plagosura rëndë partizanet Lejla Malo dhe Urani Bari. Me organizimin e batalionit “Lefter Talo” u ngarkua me detyrën e komisarit të kompanisë, ndërsa me formimin e BrXIVS, nga detyra e komisarit, pas çlirimit të Spilesë kaloi në aparat politik të komandës së përkohshme të Jugut me qëndër në Vlorë.

I palodhur në detyrat e ngarkuara...

Në nëntor të vitit 1944, Vasil Muratin e caktojnë përgjegjës politik të komandës së vendit Aliko dhe komandant mësuesin Jorgo Stamati, duke punuar për zgjidhjen e mjaft problemeve dhe detyrave të mëdha të pasluftës. Ai drejtoi punimet në rrugën e re automobilistike me të rinjtë vullnetarë në Vurg e Theollogo. Pastaj u dërgua për studime në shkollën e Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe pas përfundimit të saj u emërua në komandën e brigadës së Kufirit në Jurgucat, me shërbim në zonën e Theollogos, zbulues. Ai kishte detyrë vendosjen e kontakteve me Ushtrinë Demokratike Greke. Në qershor të vitit 1948, Vasli ishte me detyrë hetues në degën e Brendshme në Delvinë. Më datë 29 qershor 1948, në ambientet e brendshme të hetuesisë u prenë dritat dhe u thirr Vasili për rregullimin e tyre, pasi kishte njohuri në punën e elektricistit, se kishte mësuar nga italianët në bazën e Limjonit dhe në Tiranë, gjatë studimeve në shkollën e Ministrisë e Punëve të Brendshme. Kontrollloi linjën, siguresat dhe shkoi drejt motorit të dritave, afër përroit, por u qëllua befasisht pas shpine...

Të gjithë ditat, blloqet, fletore shënimesh, emra të dëshmorëve dhe materiale të tjera të Vasil Muratit u morën në vitin 1948, nga familja për t’u vendosur në muzeun e Delvinës, por deri në vitin 1997, këto ishin të ekspozuara si “trofe” në një muze në Janinë, të çuar prej Panajot Çamatit kur u arratis...

Vasil Kristo Murati është dekoruar me Medaljen e Kuqimit, Medaljen e Çlirimit, Medaljen e Trimërisë dhe Medaljen e 10 korrikut. Vasil Murati është përkujtuar në përvjetorët e BrXIVS dhe të BrXIXS. Atij iu ngrit lapidari i parë në Delvinë. Në muze të Delvinës, Sarandës dhe të MPB kishte stendë dhe relikte të tij. Ai është shpallur “Dëshmor i Atdheut” me vendim nr. 166, datë 27.12.1977 të Komitetit Ekzekutiv të rrethit Sarandë, si dhe me vendim nr. 13, datë 2.9.2003 të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”. Në qytetin e Delvinës një rrugë mban emrin e tij, si dhe Qendra Shëndetësore e Memoraqit. Varri i tij gjendet në varrezat e dëshmorëve të bashkisë Delvinë.

Për jetën dhe veprimtarinë e dëshmorit Vasil Murati është shkruar në organet e Punëve të Brendshme, në gazetata “Llaiko Vima”, “Fitore”, “Bashkimi” dhe në revistën “Në shërbim të popullit”, në librin “Heronj të heshtur”, vëllim IV, etj. Për Vasilin është shkruar monografia “Vasil Murati, luftëtari i idealeve të mëdha” nga Kiço Murati dhe botuar në vitin 2023.



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ:
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-n

25 vjet ose plot një çerek shekulli më parë, nisi zbarkimi i trupave tokësore të NATO-s në Kosovë. Prandaj 12 Qershori 1999, mbetet përjetësisht i skalitur në memorien e historisë sonë kombëtare, si data zyrtare e çlirimit të Republikës së Kosovës nga ushtria barbare e Millosheviçit.

Para së gjithash, si për çdo 12 qershor, dëshiroj t’ju përcjell mbarë-shqiptarëve, urimet më të përzemërta për 25-vjetorin e çlirimit nga pushtuesit sllav të gjysmës së kombit, Kosovës sonë martire.

Me këtë rast, na duhet ta përsërisim edhe më fort, që12 Qershori 1999, është jo vetëm një datë e përuljes së mbarë-shqiptarëve ndaj të rënëve/Dëshmorëve të Atdheut, por mbetet edhe një datë e nderimit të merituar ndaj luftëtarëve si dhe sakrificat popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi në shekuj.

Por 25 vjet mbas çlirimit të Kosovës nga pushtimi Serb, shpresoj edhe më shumë që memorien Institucionale dhe kombëtare do të mbetet përjetësisht e kthjellët, që: “çlirimi i Kosovës dhe realiteti i ri gjeopolitik, nuk erdhën brenda një date të vetme (12 Qershor 1999)”, pasi ashtu si edhe njihet botërisht: çlirimi nga pushtimi serb më 12 qershor 1999, nuk u arrit vetëm nga luftërat, gjaku i derdhur, qëndresa si dhe sakrificat sublime në shekuj të popullit të Kosovës!

Prandaj, për shkak të të vërtetave, shpresoj që Ne si Komb ta “pranojmë fisnikërisht” se kryesisht (sigurisht jo vetëm) falë ndërhyrjes së fuqisë ajrore të NATO-s, Millosheviçi u imponua të nënshkruajë kapitullimin dhe tërheqjen e forcave pushtuese (ushtarake dhe policore) deri në kufijtë e përcaktuar nga rezoluta 1244, kufij që u shenjtëruan edhe në Flamurin e Republikës së Kosovës nga Sh. T. Presidenti Ibrahim Rugova.

Po ashtu, do të mbetet përjetësisht e mirënjohur se, që para datës 12 Qershor, pra nga 24 Marsi historik deri më 10 Qershor 1999 (kur Sekretari i Përgjithshëm z. Solana, urdhëroi ndalimin e bombardimeve ndaj Serbisë); SHBA/MB dhe NATO u angazhuan për herë të parë në një fushatë ajrore ose në luftë “jashtë artikullit 5” (pa miratimin e KS/OKB), por ndërsa gjykata e legjitimoi, historia e ri-konfirmoi NATO-n si: “Aleancën më të fuqishme ushtarake si dhe e besimit te liria, paqja dhe vlerat demokratike në mbarë botën”.

Së dyti, përtej definicioneve në doktrinat e luftës (mbi pushtimin dhe çlirimin), në vijim po paraqes fakte dhe konsideratë strategjike: pse 12 Qershori 1999 është zyrtarizuar si data e çlirimit të Kosovës?

Më 9 Qershor 1999 (pra 3 ditë para datës 12) në Kumanovë të MV ishte nënshkruar Marrëveshja Teknike Ushtarake ndërmjet palës fituese/NATO dhe palës humbëse/RFJ, marrëveshje që hyri në fuqi më 11 Qershor 1999, duke legjitimuar ndërhyrjen me trupa tokësore ditën tjetër, 12 Qershor 1999. Me Marrëveshjen e Kumanovës, NATO ndaloi bombardimet ndërsa Serbia detyrohej të tërhiqte të gjitha forcat policore dhe ushtarake nga territori i Kosovës. Por, në Kumanovë përfaqësuesit e UÇK-së nuk ishin as palë nënshkruese, as prezente, ndërsa u vendos shndërrimin i UÇK-së në Forcat e Sigurisë së Kosovës.

Pra, më 12 Qershor 1999, NATO nisi zbarkimin e trupave të këmbësorisë në Kosovë, dy ditë më parë (10 Qershor) Këshilli i Sigurisë së OKB-Së, kishte miratuar Rezolutën e Ahtisaarit nr. 1244, sipas të cilës në Kosovë u legjitimua dërgimi i 37 200 ushtarë të KFOR-it nga 36 shtete. Thënë këto, ndërhyrja e NATO-s me trupa tokësore, konfirmoi vendosmërinë e perëndimit për të gjuhëzuar një kriminel lufte si Millosheviçi, si dhe me gjithë përpëlajtjet e Ariut të plagosur/Rusisë, kjo ngjarje ndryshoi përjetësisht hartën gjeopolitike të rajonit, në favor Aleancës Euroatlantike si dhe të kombit Shqiptar.

Së treti, pa mëdyshje, që edhe 25 vitet pas çlirimit të Kosovës apo 30 muajt e luftës neo-naziste të Rusisë-Putiniste në Ukrainë, qëndrimet dhe veprimet e Beogradit Zyrtar, i gjej të sinkronizuara me ëndrrat dhe interesat gjeopolitike të Rusisë në Ballkan. Gjithsesi, Moska ka dështuar për të ndezur një front të ri lufte, duke frymëzuar dhe armatosur grupet kriminale në veri të Kosovës si dhe për të mbajtur ndezur frymën anti-perëndimore/USA në rajon.

Pavarësisht kësaj, ndër aktorët rajonalë në krye qëndron presidenti serb Vuçiç, i cili, pasi ka dështuar për të bërë viktimën apo për të pirë nga 4 nëna (Moskë, Washington, Bruksel, Pekin), së fundmi dalldisi se: “solidariteti i BE-së është një përrallë”, si dhe bëri thirrje për “miqësi prej çeliku” me Kinën! Po ashtu ka keq-dështuar edhe trimërimi i Tij mbas lufte mbi: “Kufijtë e rinj shtetëror në Ballkan apo (mos) njohjen e Kosovës”, të cilat vetëm minojnë dialogun dhe rrezikojnë axhendën e integritetit të Serbisë drejt BE-së.

Ndërsa, 15 vitet e fundit: “shqetësimet strategjike mbi armatosjen deri në dhëmbë dhe (keq) shpërdorimin e Beogradit nga Kremli”, i kam adresuar si pyetje të publike, ndaj z. Vuçiç: “përse shpenzon më shumë se 1 miliard euro në vit për

25 vjet çlirim, e përjetshme mirënjohja kombëtare ndaj SHBA/NATO!



armatosjen nga Rusia me Tanke; Mig-29, Helikopter luftimi, raketa Pantsir-S, etj.? Përse 3/4 e strukturave dhe fuqisë ushtarake ofensive i ka dislokuar në kufijtë shtetërorë të Kosovës?; Nga cili vend apo Aleancë rrezikohet tërësia territoriale e Serbisë?; Apo, integritetin e cilit vend sovran, përveçse të Kosovës kërcënon Serbia? Thënë këto, më duhet ta përsëris qartë, përfshi për gjeneralët dhe mendjet putiniste jo vetëm në Beograd: për sa kohë të ketë prezencë të SHBA/NATO në terren, agresioni ushtarak kundër tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, përveçse një aventurë vetëvrasëse e Serbisë mbetet një mision tërësisht i pamundur!

Së katërti, me gjithë përpjekjet dhe progresin 25 vjeçar për t’u larguar nga urrejtja dhe gjakderdhja shekullore, paqja, siguria, stabiliteti demokratik dhe ardhmëria euroatlantike për 6 vendet e Ballkanit Perëndimor mbetet ende një sfidë serioze. Edhe përgjatë çerek shekullit të fundit: Ambiciet gjeopolitike të Rusisë – Putiniste; ushtarët e oscilacioneve të Millosheviçit në Beograd apo Dodikët e drogim nga Moska, jo vetëm kërcënojnë sovranitetin e Kosovës, por edhe stabilitetin dhe axhendën e integritetit të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (përfshi Serbinë), si dhe sfidojnë vlerat demokratike, fuqinë ushtarake, kohezionin dhe interesat e Aleancës Euroatlantike (USA/NATO/UK/BE) në rajon. Gjithsesi, përkundër riciklimit të rrënjëve të konfliktit besoj edhe më fort se paqja mbetet opsion dhe misioni i vetëm, në mënyrë që siguria të perceptohet dhe konsumohet përtej historisë së përgjakshme, në interes të sigurisë së jetës, pronës, prosperitetit të qytetareve edhe në vendet e Ballkanit ende të pa integruara në BE.

Nga ana tjetër, historia e mbas konflikteve na ka treguar, se marrëveshjet e Paqes nuk kanë për të funksionuar, pa shtruar themelet e mirëbesimit reciprok mes popujve. Krimea, është shembull i gjallë, ku arrijtjet nga Marrëveshja e Paqes-2014, po shpahen me gjakun e qytetarëve Ukrainas dhe Rus.

Së pesti, fatkeqësisht për 25 vjet, palët ende nuk po i zgjidhën dot mosmarrëveshjet ndërshtetërore dhe ndërkuftare, ndërsa Serbia dhe Kosova do duhet të tregohen seriozë për të zhvilluar masat e mirëbesimit reciprok dhe bashkëjetesës paqësore mes popujve. Në kapacitetin e ekspertit, në vijim gjeni përmbledhje me “5 rekomandime strategjike” për sigurinë afatgjatë dhe ardhmërinë Euroatlantike rajonit:

1. Beogradit zyrtar i duhet “t’i harrojë kërcënimet-neo-Staliniste” për valëvitjen e flamurit Serb në Kosovë si dhe riciklimin e fushatave të përgjakshme ndaj popullit Shqiptar. Për të mirën e Serbisë, të mos shpenzojë kot 1 miliard € në vit nga taksat/mundi i popullit serb, pasi ka ZERO, aftësi, ose këllqe të përballet me fuqinë ushtarake të USA/NATO-s dhe aftësitë e përmirësuar të FSK-së; të heqë dorë nga ëndrrat për “të pirë” nga 4 nëna (Moska, Brukseli, Uashingtoni dhe Pekini). Ndërsa, z. Vuçiç të mos riciklojë oscilacionet e Millosheviçit dhe as të bëjë trimin e tërbuar, duke kërcënuar Perëndimin (ose me Serbinë ose me Kosovën..!); por as viktimën dhe as të irrituarin, pasi,

siç është konfirmuar nga Pentagoni edhe 246 raketat “Javelin” të miratuara nga DASH/SHBA për FSK-në, nuk janë kapacitete sulmuese por për të ushtruar të drejtën sovranë të vetë-mbrojtjes territoriale të Kosovës nga çdo armik potencial, që në fakt mbetet vetëm Serbia, apo Jo?

3. Prishtina Zyrtare, pa u konsultuar me SHBA-të, kurrësi nuk do duhej/t të marrë vendimmarrje me impakte strategjike, që minojnë themelet e besimit me “çlirimtarët e vërtetë/USA/NATO, që prej 25 vitesh vijnë në mbajnë peshë kritike për sigurinë dhe ardhmërinë e Kosovës”. Për më shumë, do t’i këshilloja vëllazërisht aktorët mendje hapur të Prishtinës që: “riciklimin e kërcënimeve ushtarake të Beogradit ndaj Kosovës”, të mos e konsiderojnë me triumfalizëm populist, por si “përgjegjësi e lartë shtetërore për të ndërtuar Kosovën moderne”, përtej prezencës së NATO-s (që nuk do të jetë e përjetshme); vendin ku, qytetarët pavarësisht përkatësive etnike, fetare dhe politike të ndihen të barabartë para ligjit, si dhe faktorizimin e Kosovës nga konsumatore në kontribuuese për sigurinë si dhe integritimin e rajonit në NATO dhe BE!

3. Ndërsa, partnerëve strategjik, aktorëve dhe Ekspertëve/kolegëve në rajon, Uashington, Bruksel, etj., do t’i ri-sugjeroja që perspektivën e paqes dhe stabilitetin e Rajonit, ta para-kushtëzojnë me rikthimin e vetëm dy Masave të Mirëbesimit Reciprok, nëpërmjet të cilave Beogradi “të imponohet” se: (A) do të ruajë balancat e fuqisë ushtarake, duke mos kërcënuar integritetin territorial të Kosovës; (B) nuk do të vendosë instalime dhe as aktivitete ushtarake (25 km distancë ajrore dhe 10 km tokësorë), në kufijtë shtetërore mes vendeve, dy kushte që gjithsesi duhet të monitorohen nga USA/NATO/BE, që mbeten faktorë kritik për paqen në rajon.

4. Përkundër: “vendimmarrjeve të pa konsultuara dhe kakofonisë internacionaliste”, Tirana dhe Prishtina zyrtare, e kanë përgjegjësi të lartë shtetërore të demonstrojnë mirënjohje kombëtare ndaj SHBA/NATO/MB, ndërsa për projektin “2 Shtete Sovrane, 1 Komb i vetëm” duhet të garantojnë SHBA/NATO/BE se kjo “qasje e vonuar” nuk kërcënon por do të kontribuojë për paqen afatgjatë në 6 vendet e rajonit, përfshi Serbinë.

Në vend të përmbledhjes, përsëris që, 12 Qershori 1999 mbetet një datë për të na kujtuar Ne si Komb, jo vetëm çlirimin e Kosovës nga pushtuesit Serb, si ngjarje që meriton të skalitet edhe si datë e mirënjohjes mbarë-Kombëtare ndaj SHBA/NATO-s por si dhe dita e falënderimeve ndaj 36 vendeve si dhe emër për emër mbi 500 mijë ushtarakëve të KFOR-it, që për 25 vjet vijnë në mbrojnë paqen në Kosovë dhe Rajon.

Ndërsa, përkundër riciklimit të urrejtjes dhe gjakderdhjes shekullore, besoj edhe më fort se 12 Qershori 1999 do të mbetet një kampion për të mbajtur zgjuar kujtesën e popujve të Ballkanit Perëndimor: paqja mbetet misioni i vetëm, në interes të sigurisë së jetës, pronës, mirëqenies së qytetarëve si dhe ardhmërisë euroatlantike të Shqipërisë, Kosovës, MV, Malit të Zi, Bonje-Hercegovinës dhe Serbisë!

Gratë e fuqishme të Europës

Gratë që do drejtojnë Europën

Në një botë të rrezikshme, Europa 'e vjetër', e gjen veten në një pozitë alarmante. Në Ukrainë, vazhdon lufta më e përgjakshme që nga viti 1945, ndërkohë që Rusia, përbën një kërcënim për hapësirën kibernetike. Ekonomia e kontinentit, është e ndjeshme ndaj goditjeve të shkaktuara nga politika industriale. Populistët euroskeptikë, janë duke ecur lart në sondazhe.

Për t'u përballur me këto rreziqe, Europa ka nevojë, së paku, për një udhëheqje koherente në Bashkimin European. Ajo gjithashtu, duhet të mbajë ekstremistët jashtë pushtetit.

Nëse do të ketë sukses, varet pjesërisht në zgjedhjet e tre grave: Ursula von der Leyen, presidentja e Komisionit European, Giorgia Meloni, kryeministre e Italisë dhe Marine Le Pen, populistja kryesore e Francës.

Ursula von der Leyen, ka udhëhequr krahun ekzekutiv të BE-së, që nga viti 2019, dhe kandidoi për një mandat të dytë. Ajo e meriton një mandat të dytë.

Ka bërë një punë të mirë, duke marshuar përgjigjen e fortë kolektive të BE-së, ndaj agresionit të Vladimir Putinit dhe duke ndihmuar, në thellimin e integritit europian, në një kohë vendimtare, për shembull duke nxitur një program novator për emetimin e borxhit të përbashkët.

Një konservatore gjermane gjakftohtë, ajo e ka vënë gjithashtu Komisionin European, në qendër të vendimmarrjes, kur marrëdhëniet franko-gjermane, kanë qenë të acaruar. Duke pasur parasysh kërcënimet, nevoja për një udhëheqje të fortë dhe të unifikuar, nuk ka qenë kurrë më e madhe.

Në teori, ajo do të gëzojë mbështetjen e grupimeve konservatore, liberale dhe socialiste.

Si kandidatja kryesore për grupin kryesor të EPP-së, ajo tani do të marrë edhe pesë vjet të tjera në krye të krahut ekzekutiv të BE-së.

Por, për shkak se politika është bërë kaq e fragmentuar, këto tre grupime, parashikohen kolektivisht të fitojnë vetëm një shumicë të vogël të vendeve. Zonja Meloni, kryeministre e Italisë, që nga viti 2022 dhe liderja e partisë së djathtë Vëllezërit e Italisë (Fratelli d'Italia), e cila është kthyer, nga një forcë kryengritëse, në drejtimin e vendit. Me mbështetjen e saj, zonja von der Leyen, mund të ketë një shans më të mirë për të fituar një shumicë parlamentare, për një mandat të dytë, në postin kryesor të BE-së. Ajo në një takim me Giorgia Melonin është shprehur: "Kam punuar shumë mirë me Giorgia Melonin".

Këto fjalë, dhe ideja e çdo lloj pakti, që përfshin partinë e Melonit, ka zemëruar liberalët dhe figurat e BE-së, duke përfshirë disa në Partinë Social Demokrate në pushtet në Gjermani, dhe partinë e Emmanuel Macron në Francë. Për ta, zonja Meloni është në të njëjtin nivel si Viktor Orban, njeriu i fortë i Hungarisë.

Ajo ka bërë kauzë të përbashkët, me znj. von der Leyen, për çështje të tilla si emigracioni i paligjshëm, dy gratë kanë bërë vizita të përbashkëta, në vendet e Afrikës së Veriut, duke arritur marrëveshje me autokratë, për të frenuar rrjedhën. Ajo ka qenë një mbështetëse e fortë e Ukrainës, ndryshe nga disa shokët të saj, në të djathtën populiste.

Zonja Lë Pen, partia e saj National Rally, është përpjekur të riemërojë veten, si një figurë kryesore. Një rrugë, mund të sigurojë udhëheqje të qëndrueshme, në nivel BE-je, dhe të tregojë sesi të moderuarit, mund të përballen me inteligjencë, me të djathtën populiste.

Partia e francezes Marin Lë Pen ka hyrë me ide të qarta në zgjedhjet për parlamentin e ri europian. Dy nga objektivat kryesorë janë eliminimi i Komisionit European dhe reformimi i vetë parlamentit.

Eliminimi i Komisionit European dhe reformimi i parlamentit janë disa nga propozimet e partisë së Marin Lë Pen që prezantoi në Strasburg manifestin e saj për zgjedhjet parlamentare



**NËSE DO TË KETË SUKSES, VARET
PJESËRISHT NË ZGJEDHJET E TRE GRAVE:
URSULA VON DER LEYEN, PRESIDENTJA E
KOMISIONIT EUROPIAN, GIORGIA MELONI,
KRYEMINISTRE E ITALISË DHE MARINE LE
PEN, POPULISTJA KRYESORE E FRANCËS.**

europiane.

Lë Pen u shpreh se dëshiron të çlirojë kombet nga një Bashkim European që i mbyt dhe i privon nga sovraniteti i tyre, dhe që seriozisht minon demokracinë.

Por ideja e mos pasjes së një krahu ekzekutiv dhe eliminimi i gardianit të traktateve konsiderohet si absurd nga eurodeputetët gjermanë. Nga radhët e partisë së gjelbër shprehen se Komisioni European i shërben interesave të të gjithëve. Lë Pen kërkon që të

jenë shtetet anëtare që të vendosin, në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet një reformimi të parlamentit europian që u shërben kombeve.

Sipas tyre parlamenti europian është i përbërë nga deputetë kombëtarë, dhe kjo formulë ekziston që nga 1979. Partia e Lë Pen kërkon dhe ndryshime Brenda bankës qendrore dhe në Fronteks, i cili merret me kufijtë. Sipas sondazheve partia është në të njëjtin nivel votash me grupimin politik të Emanuel Makron.

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Ministrat e Mbrojtjes aleatë u takuan në selinë e NATO-s në Bruksel, më 13 dhe 14 qershor 2024. Takimi u kryesua nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, i cili përshkroi më herët prioritetet. Në takimin e Këshillit NATO-Ukrainë, aleatët diskutuan mbi “sigurimin e mbështetjes të parashikueshme për Ukrainën për një kohë të gjatë”. Ministrat miratuan një plan që NATO të udhëheqë koordinimin e ndihmës dhe trajnimit të sigurisë, “një element kyç për paketën tonë për Ukrainën në Samitin e Uashingtonit, së bashku me një angazhim financiar afatgjatë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. Aleatët kanë ofruar 40 miliardë euro mbështetje ushtarake për Ukrainën çdo vit dhe NATO duhet ta mbajë këtë nivel mbështetjeje në minimum, dhe për aq kohë sa duhet.

Ministrat trajtuan gjithashtu masat për të vazhduar forcimin e parandalimit dhe mbrojtjes së NATO-s. Shpenzimet e mbrojtjes janë në një trajektore në rritje në të gjithë Aleancën, theksoi Sekretari i Përgjithshëm. Në takimin ministror, aleatët bënë përparim në Premtimin e ri Industrial të Mbrojtjes që udhëheqësit do ta miratojnë në Uashington për të rritur prodhimin ushtarak dhe për të dërguar një sinjal të kërkesës afatgjatë për industrinë. Ministrat morën gjithashtu vendime për të siguruar aftësitë e nevojshme për planet e reja të mbrojtjes së NATO-s dhe ata diskutuan fushatën e intensifikimit të akteve armiqësore të Rusisë në vendet e NATO-s. Ministeriali përfshiu gjithashtu një takim të Grupit të Planifikimit Bërthamor, ku aleatët diskutuan përshtatjen e vazhdueshme të aftësive bërthamore të NATO-s.

Duke pranuar mjedisin sfidues të sigurisë, Stoltenberg përsëriti angazhimin e NATO-s për të ruajtur paqen, për të parandaluar shtrëngimin dhe për të penguar agresionin. “Ne forcojmë mbështetjen tonë për Ukrainën, forcojmë mbrojtjen tonë dhe dërgojmë një mesazh të fortë parandalimi për kundërshtarët tanë”, - tha ai.

Moment kritik për Ukrainën dhe sigurinë

Gjatë takimit dyditor, fokusi ishte përgatitja për Samitin e NATO-s në Uashington në korrik, si dhe zhvillimi i takimit të Këshillit NATO-Ukrainë, ku aleatët diskutuan se si të sigurojnë mbështetje të parashikueshme për Ukrainën për një kohë të gjatë. “Ne jemi bashkë në një moment kritik për Ukrainën dhe sigurinë tonë. Siç e kemi parë muajt e fundit, vonesat në ofrimin e ndihmës ushtarake për Ukrainën kanë pasur pasoja në fushën e betejës. Por edhe një herë aleatët po rritin mbështetjen e tyre. Unë mirëpres paketën prej 60 miliardë dollarësh nga Shtetet e Bashkuara dhe angazhime të rëndësishme nga aleatët e tjerë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm.

Në javët e fundit, Suedia, Spanja dhe Belgjika kanë premtuar secila më shumë se 1 miliard euro në mbështetje të re, përfshirë 30 avionë F-16 dhe aeroplanë paralajmërues të hershëm. Pas ofertës së Gjermanisë për një bateri shtesë “Patriot”, Italia ka premtuar një tjetër SAMP/T. “Pres që të njoftohen për më shumë në ditët dhe javët në vijim”, - tha në konferencën për shtyp Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg përpara takimit të ministrave të Mbrojtjes. “Unë pres që ministrat të miratojnë një plan që NATO të udhëheqë koordinimin e ndihmës dhe trajnimit të sigurisë në Ukrainë. Ky është një element kyç për paketën tonë për Ukrainën në Samitin e Uashingtonit, së bashku me një angazhim financiar afatgjatë”, - tha ai.

Që nga pushtimi i plotë i Rusisë në vitin 2022, aleatët kanë ofruar 40 miliardë euro mbështetje ushtarake për Ukrainën çdo vit. Që nga viti 2014, NATO ka zbatuar përforsimin më të madh të mbrojtjes sonë kolektive në një brez. Ajo ka vënë në zbatim planet më gjithëpërfshirëse të mbrojtjes që nga fundi i Luftës së Ftohtë dhe shpenzimet e mbrojtjes janë në një trajektore në rritje përgjatë Aleancës. “Në këtë ministerial, ne do të bëjmë përparim në një premtim të ri Industrial të Mbrojtjes, që liderët të miratojnë në Samitin në Uashington. Kjo do të na mundësojë të rrisim prodhimin ushtarak dhe dërgon një sinjal të kërkesës afatgjatë në industri. Përveç kësaj, ne do të marrim vendime për të siguruar që kemi aftësitë për të përmbushur kërkesat e planeve tona të reja të mbrojtjes”, - tha Stoltenberg dhe theksoi se ministrat do të diskutojnë gjithashtu fushatën e intensifikimit të akteve armiqësore të Rusisë në vendet e NATO-s, shenjat dalluese të cilave janë sabotimi, aktet e dhunës, sulmet kibernetike dhe dezinformimi. “Aleatët po marrin masa vendimtare, duke bërë arrestime dhe duke nisur procedurat ligjore. Së bashku, ne jemi duke rritur mbrojtjen e infrastrukturës kritike, si dhe shkëmbimin e informacionit dhe inteligjencës. Veprimet e Rusisë nuk do të na ndalojnë të mbështesim Ukrainën”, - tha shefi i NATO-s.

Ministeriali përfshiu gjithashtu takimin e Grupit të Planifikimit Bërthamor, ku aleatët diskutuan përshtatjen e vazhdueshme të aftësive bërthamore me mjedisin aktual të sigurisë. “Ne kemi bërë përparim të rëndësishëm në këtë përshtatje, në qershor, avionët e parë luftarakë F-35 u deklaruan të gatshëm nga Holanda për misionin bërthamor të NATO-s dhe SHBA po modernizon armët e saj bërthamore në Evropë. Ndërsa sfidat evoluojnë, misioni bërthamor i NATO-s mbetet i njëjtë: të ruajë paqen, të parandalojë detyrimin dhe të pengojë agresionin.

Forcimi i mbështetjes së NATO-s për Ukrainën

Aleatët ranë dakord për një paketë gjithëpërfshirëse për Ukrainën dhe kjo është një marrëveshje që NATO të ketë një rol udhëheqës në ofrimin dhe koordinimin e ndihmës ushtarake për sigurinë dhe trajnimin për Ukrainën. Kjo është e rëndësishme sepse e ndihmon Ukrainën të adresojë nevojat urgjente për t'u mbrojtur, por gjithashtu për të siguruar që NATO është aty për

NATO përgatitet për Samitin e Uashingtonit: Forcimi i mbrojtjes, mbështetja për Ukrainën dhe mesazhi i fortë për kundërshtarët



të ndihmuar në ndërtimin e një force të ardhshme për të siguruar ndërveprim të plotë, dhe për të ndihmuar Ukrainën të shkojë drejt anëtarësimit të plotë në NATO. “Miratimi i premtimit financiar, është diçka që ne po trajtojmë tani këtu në NATO ndërsa përgatitemi për samitin e ardhshëm në korrik dhe ky do të jetë gjithashtu një angazhim afatgjatë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. “Ajo që mund të them sot është se tani kemi një marrëveshje shumë të gjerë në NATO dhe gjithashtu faktin që kemi gjetur një mënyrë për të akomoduar shqetësimet e shprehura nga Hungaria për të siguruar që NATO të marrë një rol udhëheqës në koordinimin e ndihmës dhe trajnimit të sigurisë”, - tha Stoltenberg. “Një nga gjërat që po shqyrtojmë tani është për shembull, ajo që po ndodh nën diçka të quajtur SAG-U, Grupi i Asistencës së Sigurisë për Ukrainën, i cili është kryesisht i bazuar në ‘Wiesbaden’, që në fakt është një organizatë mjaft e madhe që ndihmon për të bashkuar paketat e aftësive, lloje të ndryshme armësh ose municionesh, me pjesët e ndërlidhura të këmbimit, mirëmbajtjen, dhe gjithashtu koordinimin e shumë trajnimeve”. Ky grup udhëhiqet aktualisht nga gjenerali Cavoli në cilësinë e tij si komandant i SHBA-së në Evropë. Në të ardhmen do të drejtohet edhe nga gjeneral Cavoli, por më pas në cilësinë e komandantit të NATO-s në Evropë, SACEUR. Stoltenberg tha se: “ky është një shembull se si ne, duke përdorur NATO-n, mund të kemi një kornizë më të fortë, më të parashikueshme, dhe veçanërisht të kombinuar me një angazhim për të shpenzuar të paktën 40 miliardë euro në vit. Kjo do të sigurojë që ne të kemi një mbështetje më afatgjatë dhe më të parashikueshme për Ukrainën. Ne mirëpresim sigurisht kontributet vullnetare ad hoc, ato kanë bërë një ndryshim të madh. Por sa më gjatë të zgjasë kjo luftë, aq më e rëndësishme është që të kemi më shumë parashikueshmëri, më shumë llogaridhënie dhe gjithashtu një ndarje të drejtë të barrës”, - tha ai. Duke i siguruar NATO-s një rol më të madh, kemi një rol të NATO-s në sigurimin e më shumë transparencë dhe llogaridhënie. “Ne sigurisht vlerësojmë atë që kanë bërë Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tjerë. Është e paprecedentë. Në të njëjtën kohë, ne pamë se Shtetet e Bashkuara kaluan gjashtë muaj duke rënë dakord për një shtesë për Ukrainën. Ne kemi parë gjithashtu se disa nga premtimet që kanë bërë Aleatët Evropianë nuk janë realizuar. Dhe nëse këtë e kthejmë në kontribute jo vullnetare, por në angazhime të NATO-s, sigurisht që do të bëhet më e fortë, do të bëhet më e besueshme. Dhe për të gjitha këto arsye, unë besoj se një rol më i fortë i NATO-s do ta ndihmojë Ukrainën të marrë parashikueshmërinë që i nevojitet”, - tha Stoltenberg.

NATO forcon mbrojtjen dhe parandalimin

“Premtimi i investimit në mbrojtje është një dokument i rëndësishëm politik, ku aleatët bien dakord se si duhet të punojmë së bashku për të forcuar industrinë tonë të mbrojtjes. NATO ka një rol të rëndësishëm dhe kyç për të luajtur, pjesërisht për të vendosur objektivat e aftësisë për atë që aleatët duhet të prodhojnë, pjesërisht për të vendosur se sa do të shpikim në premtimin për investime në mbrojtje, duke shpenzuar të paktën 2% të PBB-së. Por NATO sigurisht luan gjithashtu një rol kyç kur bëhet fjalë për vendosjen e standardeve për të siguruar që armët, municionet, të jenë plotësisht të ndërveprueshme dhe të përmbushin standardet e NATO-s”, - shpreh Stoltenberg. Sekretari i Përgjithshëm tha se është e rëndësishme gjithashtu që NATO të sigurojë që po reduktin barrierat për tregtinë dhe për prokurimin e materialit mbrojtës, sepse duhet mobilizimi i gjithë bazës, forcës së industrisë të mbrojtjes, pasi në fund të ditës, ajo që ka vërtet rëndësi janë kontratat e nënshkruara me industrinë. “SHBA-të kanë njoftuar se kanë dyfishuar, për shembull, prodhimin e municioneve standarde mbi 155 milimetra nga 14 në 28 000 në muaj, dhe kjo do të rritet më tej me 200 000 në të ardhmen e afërt. Kjo është një rritje e konsiderueshme në muaj dhe ne do të shohim numra të ngjashëm nga aleatët evropianë. Pra, kjo reflekton se ne në fakt po bëjmë më shumë së bashku”, - tha Stoltenberg. Përdorimi i ekonomive do të zvogëlojë koston për

njësi dhe fakti që aleatët po nënshkruajnë kontrata të bashku është një mënyrë për të përdorur pastaj NATO-n si një platformë për të rritur prodhimin. “Pra, ne kemi gjithnjë e më shumë shembuj të shkallëzimit dhe prodhimit të industrisë së mbrojtjes bazuar në vendimet politike në NATO dhe vendet aleate”. Stoltenberg tha se Kina po luan tani një rol kyç në mbështetjen e luftës së Rusisë në Ukrainë: “90% e mikroelektronikës që Rusia importoi vitin e kaluar erdhi nga Kina dhe këto janë artikuj, pajisje elektronike, të cilat janë kyçe për prodhimin e raketave, bombave, tanke luftarake, të cilat më pas përdoren në agresionin luftarak të Rusisë kundër Ukrainës. Kështu që Kina po mbështet, Kina po i mundëson Rusisë të zhvillojë luftën e saj të agresionit në Ukrainë ose kundër Ukrainës”. Ai theksoi se ajo që ne shohim tani në Ukrainë është shumë e qartë, shohim se si është e ndërlidhur siguria jonë. “Ajo që ndodh në Evropë ka rëndësi për Azinë, ajo që ndodh në Azi ka rëndësi për Evropën, veçanërisht nëse pastaj shtoni edhe furnizimet që Koreja e Veriut dhe Irani po i dërgojnë Rusisë”, - tha Stoltenberg.

Aftësitë bërthamore të NATO-s, mesazh i fortë frenimi për kundërshtarët

Parandalimi bërthamor i NATO-s është garancia jonë përfundimtare e sigurisë dhe parandalimi ynë përfundimtar dhe kjo është diçka që është zhvilluar gjatë shumë viteve për marrëveshjet e ndarjes bërthamore, ku SHBA-të kanë armë bërthamore në Evropë, por ku aleatët po ofrojnë avionët, ruajtjen, komandën dhe kontrollin, mbështetjen për ta bërë këtë pjesë efektive dhe të sigurt të parandalimit dhe mbrojtjes totale të NATO-s. “Ajo që kemi parë gjatë viteve apo muajve të fundit është një retorikë e rrezikshme bërthamore nga pala ruse”, tha Stoltenberg. “Ne kemi parë që Rusia ka njoftuar se ka vendosur armë bërthamore në Bjellorusi dhe kemi parë edhe disa stërvitje të tjera, stërvitje bërthamore nga pala ruse. Ne gjithashtu duhet të kemi parasysh se ne nuk përballemi vetëm me sfida bërthamore nga Rusia, por edhe nga Kina, e cila tani po modernizon fuqishëm aftësitë e saj bërthamore”, - tha ai. “Ne duhet të presim që të kemi një numër të madh raketash bërthamore, shumë më të larta se sot, brenda pak vitesh, dhe shumica e shumë prej këtyre raketave janë natyrisht, ndërkontinentale, ato mund të arrijnë në territorin e NATO-s. Kemi programin bërthamor të Koresë së Veriut dhe përpjekjet e Iranit. Pra, për të gjitha këto arsye, ne duhet të jemi në gjendje të komunikojmë qartë se parandalimi ynë bërthamor është efektiv, i sigurt dhe i besueshëm, dhe këtë po e bëjmë të qartë, duke modernizuar, duke ushtruar dhe duke komunikuar atë që bëjmë”, - vërejtë Stoltenberg.

